

.....Vra sje Me Kompjuter.....

Ndryshme nga mikroorganizmat, shkaktare te semundjeve të ndryshme, viruset kompjuterike janë jo materiale dhe kanë formën e programeve me përmasa te vogla, te pregatitura nga programiste profesioniste te titulluar Hacker. Këto viruse nuk kanë kufinj apo largesi gjeografike, i rezistojne kohës dhe janë te pa kapshem nga shqisat e njeriut. Ato janë te aftë për te levizur vete nëpër rrjetet kompjuterike, te maskohen, te shkaterojne barrierat mbrojtese Antivirus, te shumefishohen dhe te sjellin deme te pallogaritshme duke mbetur përherë te padukshem, dhe një pjesë e mirë e këtyre mbasi mbarojne misjonin e tyre shkaterues, vetshkatrohen duke mos lënë asnjë gjurme, si të mos kishin egzistuar kurrë.

Nuk do ju besohet por këto krijesa informatike nund te jenë ne gjendje të vrasin edhe njerëz. Janë te shumta rastet kur viruse kompjuterike kanë hyrë dhe kanë poseduar instrumente shkencore dhe aparatura diagnostikuese mjeksore duke ndryshura parametrat dhe duke i kthyer këto istrumente ne arme vdekjeprurese për njeriun. Një pjesë e mirë e tyre bëjnë pjesë dhe ne arsenalet ushtarake dhe misjoni i tyre i vetëm është shkaterimi i gjithckaje qe gjejne përpara, një virus nuk është i dobishem për asgjë dhe është një arme e mirë lufte. Këto viruse krijohen nga njerëzitë me te ndritur te fushes informatike dhe i kalojne të gjitha perftyrimet njerzore te aftësive të tyre vrasese.

VIRUSI 666 (Simboli i Djallit).

Gjithçka ndodhii ne Francë kur një operator u gjet i vdekur përpara ekranit te kompjuterit te tij personal nga një hemoragji e pa zakonte ne tru. Ne fillim gjithçka u mendua si një mbingarkese, ose një mbi lodhje e munshme mendore, por ekspertiza mjekoligjore vertetoj te kundërtën i riu ishte ne kushte optimale fizike dhe nuk kishte asnjë patologji te munshme kardiovaskulare, nuk gjeten as shenja helmimi apo goditjesh me mjete te forta, ata ariten ne perfundimin "Hemoragjia ka një shkak te jashtem". Eksperte nga i gjithë vendi erdhen për te egzaminuar vendin e krimit dhe ariten ne perfundimin se shkaktar për vdekjen e te riut 22 vjeçar ishte një virus informatik, me emrin apokaliptik "666".

Gjithçka u izolua dhe çështja i kaloi ne dorë agjenteve te sigurimit kombëtar. U thiren ekspertet me te medhenj te fushave informatike, elektrike, inxhenieri elektronike dhe specialiste te teknologjive te avancuara. Ekspertet këtë rast e shpjeguan ne këtë mënyrë:

Ne ekranin kompjuterik njësoj si ne ekranin e kinemase apo atë televiziv, kuadrot ndryshojnë me frekuence fikse 24 Herc (24 kuadro për sekonde). Sipas specialisteve 666-ta jep ne ekran 25 Herc, domethënë një kuader me shumë nëpërmjet te cilit përfitohet një kombinim i veçantë ngjyrash. Kombinimi i ngjyrave ndryshon treguesit kryesore te veprimtarise jetësore te njeriut. Perceptimi i pavetedijshem i pamjeve te ndryshueshme shkakton crregullim te punës se

zembrës dhe tensioni arterial i gjakut brenda një segmenti të vogël kohe herë ritet dhe herë ulet ndjeshejm. Ngarkesa mbi enet e gjakut ndryshon vazhdimisht e cila çon dhe në një crregullim hormonal deri në atë pikë sa krijohet një rezonance hemostatike midis enëve dhe presionit të gjakut e cila brenda pak minutash shkakton plasjen e enëve të gjakut në tru duke shkaktuar një hemoragji endokraniale vdekjeprurëse.

Virusi 666 u vlerësua nga ekspertet si virusi më i aritur deri më sot. Askush nuk e di se si arrihet ky kombinim djallezoz ngjyrash, mendohet që 666-ta të jetë trashiguar që nga kohët e lashta pasi përveç kombinimit të frekuencës së ngjyrave janë gjetur dhe simbole antike të cilat sipas studjuesve bëjnë pjesë në disa rite antike të hipnozës, gjë e cila nuk dihet nga asnjë nga Hacker-at e sotëm. Por ajo që shqetëson me shumë ekspertet ishte që 666 përdorte sistemin Binar (2 shifror) të sotëm të rrjetit informatik por kombinimet i bënte në një gjuhë ende të panjohur Hekza (10 shifror).

Virusi nuk u arit të izolohej pasi ai arrinte të ndryshojë formë duke u shumëzuar sipas një rregulli të caktuar dhe sa herë që izolohej në një harduer pa dalje ai vetshkatrohej.

Masa e vetme që u mor kundër tij që marveshja midis sigurimit ndërkombëtar dhe kompanive me të medhaja të ndërtimit të harduerve për të shmangur ndryshimin e frekuencës në monitoret LCD dhe PLAZMA e cila do të sigurojë mosshfaqjen e 666-tes në masën 25%.

Askush nuk e di se ku ndollet 666-ta dhe se kure do të dalë përsëri në skenë, por mendohet se ai vepron ende dhe më së shumti në një sërë vrasjesh të cilat sigurimi informativ i mban tepër sekret, ose është thjeshtë një armë lufte ende në fazat fillestare të testimit.

E ardhmja e internetit në vitin 2020

Pasi intervistuan 742 ekspertë të politikës, informatikës e biznesit, disa studiues amerikanë kanë përpiluar një raport të ri mbi të ardhmen e internetit. Më shumë se gjysma e të intervistuarve besojnë se interneti që tani deri në vitin 2020 nuk do ta humbasë aspak joshjen që ushtron, përkundrazi, do të tërheqë miliarda përdorues të tjerë. Sidoqoftë, 46% e ekspertëve që pranuan të përfshiheshin në studim pranojnë se mbi këtë kanë shumë rezerva. Janna Quitney Anderson, autorja kryesore e raportit "The Future of the Internet II" (E ardhmja e internetit II), shpjegon se brezi i ri arkitektëve kryesorë të internetit bien në thelb dakord mbi ndryshimet

teknologjike që do të pësojë gjatë këtyre viteve interneti, por, kur bëhet fjalë për impaktin social dhe politik të këtyre ndryshimeve, aty lindin edhe mospërputhjet e para. Problemi kryesor që ngrenë skeptikët i përket kontrollit të internetit, i cili - me shumë gjasa - pas 13 vitesh do të përbëhet nga dispozitivë të lëvizshëm! Pa marrë parasysh që për të kryer me të vërtetë procesin e universalizimit të rrjetit është e nevojshme të kalohet pengesa që sjell mospërshtatja mes formateve aktualisht ekzistues, si edhe limiti që përbën interesat tregtare të njëjës apo tjetrës shoqëri. Me pak fjalë: është e domosdoshme që bashkëpunimi t'i mbivendoset konkurrencës. Të intervistuarit janë shprehur edhe në lidhje me temën e sigurisë dhe të gjuhës që do të dominojë në të ardhmen në internet: pjesa më e madhe e shohin me mosbesim teorinë se deri në vitin 2020 anglishtja do të jetë kthyer në gjuhën dominuese të rrjetit, ndërkohë po kaq mosbesues janë edhe ndaj faktit se siguria e rrjetit mund të lihet tërësisht në varësi të makinave. Pasi kontrolli njerëzor është i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm, të paktën për sa kohë kompjuteri nuk do të jetë i aftë të ndalë dikë t'i heqë spinën. Në fund, në rast se është e vërtetë se pas 13 vjetësh një numër gjithnjë e më i madh njerëzish do të punojnë e do të jetojnë në hapësirën kibernetike, del përpara problemi i privacisë dhe një tjetër që ka lidhje me produktivitetin e përdoruesve: a do të jetë e mundur garantimi i jetës private të secilit dhe i transparencës së rrjetit. Po punonjësit e së nesërme, do të jenë po kaq produktivë sa ç'janë të sotmit në botën reale?" Për të pasur përgjigjet nevojitet vetëm kohë.